



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja  
Ministry of Environment and Spatial Planning

Për:	Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës Arbnore Beqiraj Fera, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Kamenicës
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në MAPL Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Fitore Pacolli, Ministre në MMPH Izedin Bytyqi, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPH
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Vendim 01Nr. 3069 për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033 nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kamenicës

I nderuar kryetar Rahimaj,  
E nderuar kryesuese Beqiraj-Fera

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), në pajtim me nenin 9 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 06.02.2026 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), **Vendimin 01Nr. 3069 për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033 nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kamenicës.**

MMPH pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave kërkon nga Kuvendi Komunal i Kamenicës:

## RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT

Vendimin 01Nr. 3069 për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033 nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kamenicës

### ARSYETIMI

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pas shqyrtimit të Vendimit të lartcekur konstatoi se:

Në nenin 7 të Vendimit, duhet të shtohet një paragraf përmes të cilit bëhet shfuqizimi I Vendimit Nr. Protokolli Sh.01 Nr. 06-15525 për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2013-2023+.

Sa i përket çështjeve procedurale të cekura në Arsyetim të Vendimit, për të cilat PZHK 2025-2033 është kthyer përsëri për miratim, vlerësimi i këtyre çështjeve procedurale nuk bie në fushëveprimin e kompetencave tona, andaj nuk kemi dhënë vlerësim lidhur me këtë pjesë.

Nga ajo që u tha më lartë, të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPH, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e Ligjit Nr. 08/ L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave.

